



REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUÇITRN	
DI Nr. / Br.	156/2022
Nr. i Sq. / Br. st.	- 8 -
Datum / Datum	30.06.2022
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

**RREGULLORE**

**(KKV) NR.02/2022 PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE  
BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE  
LAGJET URBANE**

**Qershori, 2022**

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 2, shkronja "c" dhe nenit 34, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrتare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 41, paragrafi 2, shkronja "c" e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 qershor 2022**, miratoi këtë:

**RREGULLORE  
PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME  
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në themelin e këshillave lokale, në ushtrimin e aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje përfshinë të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Vushtrrisë dhe përcakton themelin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, duke formuar këshilla lokale, si trupa mbështetës të komunës dhe që të ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1 **Këshillat lokale** – nënkuption trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
  - 1.2 **Krytar i këshillit** – nënkuption personin me të votuar në tubim zgjedhor në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

**Neni 4**

**Formimi i këshillave lokale**

Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Komuna e Vushtrrisë do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokale. Një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivele të këshillave lokale dhe janë parashikuar në nenin **6** të kësaj rregulloreje.

### **Neni 5** **Komisioni për përzgjedhjen e këshillave lokale**

1. Kuvendi i komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Ky përfaqësues zgjedhet ad-hoc nga komisioni.
2. Komisioni duhet të reflektojë përfaqësim gjinor dhe etnik. Nga shtatë (7) anëtarët e komisionit, përfaqësimi gjinor do të jetë tre (3) me katër (4) të gjinive të kundërta.
3. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të komunës.
4. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës.
5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetar të këshillave lokale.
6. Së paku pesë (5) anëtarë të komisionit, prej të cilëve së paku dy (2) përfaqësues nga Kuvendi i komunës, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.
7. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
8. Komisioni i raporton Kuvendit të komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.

### **Neni 6** **Këshillat lokale të Komunës së Vushtrrisë**

**6.1** Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019, neni 4, paragrafi 2, në territorin e Komunës së Vushtrrisë themelohen këta këshilla lokale si më poshtë:

- 6.1.1. Këshilli lokal Karaçë: Karaçë, Miraçë, Shlivovicë, Gumnishtë, Skromë, Boshlan, Kurilovë dhe Vesekoc;
- 6.1.2. Këshilli lokal Begaj: Begaj dhe Gojbulë;
- 6.1.3. Këshilli lokal Studime e Poshtme: Studime e Poshtme, Studime e Epërme, dhe Skoçan;
- 6.1.4. Këshilli lokal Nedakoc; Nedakoc, Pestovë, Mavriq, Svaraçak i Poshtëm, dhe Svaraçak i Epërm
- 6.1.5. Këshilli lokal Maxhunaj: Maxhunaj, Ropicë, dhe Vilanc;
- 6.1.6. Këshilli lokal Samadrexhë: Samadrexhë, Ceceli, Sllakoc, Kunovik dhe Zagorë;
- 6.1.7. Këshilli lokal Dumnicë e Poshtme: Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Llugës dhe Dumnicë e Epërme;

- 6.1.8. Këshilli lokal Stanoc i Epërm: Stanoc i Epërm dhe Gracë;
- 6.1.9. Këshilli lokal Stanoc i Poshtëm: Stanoc i Poshtëm dhe Lumadhd;
- 6.1.10. Këshilli lokal Prelluzhë; Prelluzhë
- 6.1.11. Këshilli lokal Stroc: Stroc, Bivolak, Zhilivodë, Gllavatin dhe Beçuk
- 6.1.12. Këshilli lokal Druar: Druar, Mihaliq Reznik, dhe Shalë
- 6.1.13. Këshilli lokal Novolan: Novolan, Brusnik Kollë, Bukosh dhe Verrnic ;
- 6.1.14. Këshilli lokal Duboc: Duboc, Beçiq, Taraxhë dhe Galicë;
- 6.1.15. Këshilli lokal Akrashtic: Akrashtic, Jezerë, dhe Balincë;
- 6.1.16. Këshilli lokal Dalak; Dalak dhe Shtitaricë;
- 6.1.17. Këshilli lokal Pantinë: Pantinë, Oshlan dhe Hercegovë;
- 6.1.18. Këshilli lokal Smrekonicë: Dobërrlukë; Smrekonicë, Banjskë, Sllatinë, Pasomë dhe Tërllobuq.

**6.2.** Kufijtë territorial dhe emërtimet e lagjeve urbane përcaktohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 7

#### Njoftimi për organizimin e takimeve për përzgjedhjen e këshillave lokale

1. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë, për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
  - 1.1. Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe hapësirat më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen takimet për zgjedhjen e këshillave lokale;
  - 1.2. Mediave lokale;
  - 1.3. Ueb-faqes zyrtare të komunës;
  - 1.4. Platforma tjera të komunikimit.
2. Njoftimi për publikun duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vedin e mbajtjes së takimit.

### Neni 8

#### Përbërja e këshillave lokale

1. Këshilli lokal mund të ketë nga pesë (5) deri nëntë (9) anëtarë. Numri i anëtarëve për secilin këshill lokal, përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në takimin zgjedhor.
2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal me se paku 1 (një) anëtar. Në raste kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, atëherë fshati apo lagja urbane me numër me të madh të banorëve, përfaqësohet me 1 (një) anëtar më shumë se fshatrat tjera të këshillit lokal.
3. Anëtarë të këshillave lokale zgjedhen kandidatët, të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve me të drejtë vote të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në takim zgjedhor.
4. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të qytetarëve që marrin pjesë në takim.

5. Nëse në rrithin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrathi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.
6. Nënkyetari i këshillit zgjidhet nga kryesia e këshillit në takimin e parë të radhës pas themelimit të këshillit lokal. Për mënyrën e votimit të zgjedhjes së nënkyetarit vendos kryesia e këshillit lokal.
7. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publik në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe platformat tjera të komunikimit menjëherë pas takimit zgjedhor.
8. Prosesverbal i hartuar nga takimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vedin e mbajtjes së takimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në takim, listën e pjesëmarrësve, të dhënët për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje tjera të adresuara në takim.
9. Prosesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi i takimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi.

### **Neni 9** **Kriteret e përzgjedhjes për këshillat lokale**

1. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të janë banorë të përhershëm në atë lokalitet.
2. Kandidatët për anëtarë dhe kryetarë të këshillave lokale nuk mund të janë kandidatë nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike.
3. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të propozojë së paku dy kandidatë përfaqësim në këshillin lokal.
4. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 30 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, duke respektuar kuotën gjinore prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, dhe përfaqësimin etnik në lokalitete ku ka banorë të komuniteteve jo shumicë.
5. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore sipas nenit 9, paragrafi 4 të kësaj irregulloreje.
6. Në këshillin lokal përfaqësohet edhe komuniteti jo shumicë me numër më të madh të banorëve të atij lokaliteti, të cilët janë të pranishëm në takim dhe votojnë.
7. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në takimin e qytetarëve.

### **Neni 10** **Komisioni i ankesave**

1. Kuvendi i komunës themelon komisionin e ankesave i cili i shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.
2. Komisioni i ankesave do të ketë 3 anëtarë, të cilët zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës.

3. Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor.
4. Ankesat për parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten tek komisioni për ankesa brenda 3 ditëve të punës.
5. Komisioni i ankesave është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të ankesës t'ju kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.
6. Vendimet e komisionit të ankesave janë përfundimtare në procedurën administrative dhe të obligueshme për palët.
7. Komisioni i ankesave i raporton Kuvendit të komunës.

### **Neni 11 Mandati i këshillave lokale**

1. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vjet.
2. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon si në vijim:
  - 2.1 me përfundimin e mandatit;
  - 2.2 nëse jep dorëheqje;
  - 2.3 nëse shkarkohet;
  - 2.4 nëse ndërron vendbanimin;
  - 2.5 në rast të dënitit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër;
  - 2.6 Nëse vdes.
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.
4. Inicimi i procedurës për shkarkimin e kryetarit të këshillit bëhet me shumicën e anëtarëve të këshillit lokal dhe me peticion të nënshkruar më së paku prej 30 qytetarëve të atij lokaliteti.
5. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit lokal, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditë kalendarike duhet të organizojë zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
6. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pristes, me aprovin e komisionit të kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.

### **Neni 12 Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale**

1. Kryetari i komunës në bashkëpunim me kryesuesin e kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me kryetarët e këshillave lokale.
2. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike me qytetarë.
3. Kuvendi i komunës duhet të bëjë konsultime me këshillin lokal, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

**Neni 13**  
**Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokale**

1. Me kërkesë të këshillit lokal dhe rekomandim të Kryetarit të komunës, apo ndonjë komiteti të kuvendit, Kuvendi i komunës me vendim të veçantë mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë kompetencë ekskluzive, vetanake të komunës.
2. Këshilli lokal duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna.
3. Bartja e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal duhet të mbështetet me financim dhe burime tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sipas përgjegjësive të bartura.

**Neni 14**  
**Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit lokal**

1. Këshilli lokal mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet me interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Në mënyrë që kërkesat e qytetarëve të përcjellën rregullisht tek organet kompetente në komunë, këshilli lokal obligohet që të organizojë së paku një takim me qytetarë brenda një viti dhe sipas nevojës. Numri i takimeve të këshillit lokal svarohet më tej në nenin 17, paragrafin 5 të kësaj rregulloreje.
3. Këshilli lokal duhet të organizojë, hartojë dhe përcjellë prioritetet dhe kërkesat e lokalitetit te Kryetari, Kuvendi i komunës dhe drejtore të komunale.
4. Këshilli lokal duhet të informojë komunën për kohën, vendin dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët kompetent komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
5. Takimet e qytetarëve organizohen me iniciativën e këshillit lokal.
6. Këshilli lokal mund të ndërmarrë këto aktivitete, të cilat në veçanti ndikojnë në:
  - 6.1 Planifikimin urban dhe rural;
  - 6.2 Furnizimin me ujë;
  - 6.3 Rregullimin e kanalizimit, drenazhimi;
  - 6.4 Rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda këshillit lokal;
  - 6.5 Shëndetësinë publike;
  - 6.6 Mbrojtjen lokale të ambientit;
  - 6.7 Turizmin;
  - 6.8 Hapësirat publike dhe varrezat;
  - 6.9 Aktivitetet kulturore, arsimore dhe sportive;
  - 6.10 Aktivitetet vullnetare në interes për këshillin lokal;
  - 6.11 Mirëqenien e banorëve të këshillit lokal – sigurimi i të dhënave për çdo familje, duke përcjellë gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime për mbështetje të këtyre rasteve.

- 6.12 Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizatat tjera të shoqërisë civile – organizata joqeveritare, shoqata, klube etj., për çështje me interes për lokalitetin.
- 6.13 Zbatimin e aktiviteteve që janë bartur, sipas procedurave të nenit 11 të kësaj rregulloreje.
7. Me pëlqimin e Kryetarit të komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve për monitorimin, zbatimin e projekteve për investime kapitale në lokalitetin e tyre.
  8. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
  9. Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtronjnë kërkesë me shkrim, qoftë fizikisht apo përmes postës elektronike zyrtare, organeve kompetente të komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, dhe komuna i përgjigjet brenda afatit prej 30 ditësh.
  10. Në raste emergjente. Këshilli lokal shndërrohet në nënshtab emergjent.

### **Neni 15 Roli i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal ka obligim t'i informojë anëtarët e këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet me organet e komunës.
3. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit.
4. Kryetari i këshillit lokal nënshkruan konkluzionet, propozimet dhe kërkesat e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe eshtë i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre t'i adresojë në zyrën e Kryetarit të komunës.

### **Neni 16 Financimi i aktiviteteve**

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale, mund të financohen si vijon:
  - 1.1 Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
  - 1.2 Nga komuna;
  - 1.3 Nga donatorët;
  - 1.4 Me financim të përbashkët.

### **Neni 17 Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës me vendim të veçantë nga Kuvendi i komunës.

- Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative të komunës.
- Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.
- Kompensimi bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit sipas nenit 14, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
- Numri i mbledhjeve me kompensim është gjashtë (6), ndërsa pa kompensim mund të mbahen edhe me shumë.

**Neni 18**  
**Mos përbushja e përgjegjësive**

Këshilli lokal mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga organet e komunës në këshillin lokal.

**Neni 19**  
**Dispozitat kalimtare**

- Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e ligjit, udhëzimit administrativ apo statutit.
- Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (KKV) Nr.03/16 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillave Lokale e Komunës së Vushtrrisë e datës 28.7.2016.

**Neni 20**  
**Përgjegjësia për zbatim**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Administratë.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

